



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**

SHTOJCA 1.26

Rregullorja për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike

1.26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË



RREGULLORE

PËR

**PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E
FUNKSIONEVE PUBLIKE**

NË

UNIVERSITETIN "FAN S. NOLI", KORÇË

(Miratuar me Vendimin nr. 686, datë 24.12.2019, të Senatit Akademik të UK-së)



KREUI

RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Baza ligjore

Rregullorja "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, si dhe deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në Universitetin "Fan S. Noli", bazohet në Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të dës nëpunësve publikë", i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse, të miratuara në bazë të tyre.

Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është deklarimi dhe mbajtja e përgjegjësive për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, si dhe garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë nga zyrtarët publikë të Universitetit "Fan S. Noli" (më poshtë UK).

Neni 3 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave, procedurave, përgjegjësive dhe kompetencave për zbatimin e detyrimeve ligjore për deklarimet e pasurive, si dhe identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe dënimin e rasteve të konfliktit të interesave.

Neni 4 Përkufizime

1. "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të



CHAPTER I

GENERAL PROVISIONS

Article 1:

Legal foundations

Regulation "*On the prevention of conflicts of interest in public functions, and declaration of assets in exercising in public functions at University "Fan S. Noli", based on law 9367, dated on 7.4.2005*" "On the prevention of conflicts of interest in exercising public functions", as amended, in law no. 9049, dated on 10.4.2003 "on the declaration and audit of assets, of financial obligations of the elected officials and certain public officials", as amended in terms with the provisions of Acts and legal disposition.

Article 2 Purpose

The aim of this regulation is the declaration and the answer for the declaration and audit of assets and the guarantee for a fair and transparent decision-making, in the best possible interest of the public by public officials of the University "Fan S. Noli" (below UK), and the exercise of functions of the UK's employees not in terms of a conflict of interest.

Article 3 Objective

This Regulation lays down the rules, means, methods, responsibilities procedures, and competencies for the implementation of the legal obligations for asset declarations and the identification, declaration recording treatment, resolution and punishment in cases of conflict of interest.

Article 4 Definitions

një zyrtari të UK-së, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

2. "Kryerje në mënyrë të drejtë e detyrave dhe përgjegjësive" është mënyra e kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive, të materializuara në një vendimarrje, në të cilën zyrtari i UK-së vepron në përputhje me ligjin, me ndershmëri, paanshmëri, përgjegjësi, përkushtim, në afat, në mbrojtje, në çdo rast, të interesit publik dhe të drejtave të ligjshme të personave privatë, si dhe për ruajtjen dhe forcimin e besueshmërisë e të dinjitetit të institucionit ku punon, të shtetit në përgjithësi dhe të figurës së zyrtarit.

3. "Kryerje në mënyrë të padrejtë e detyrave dhe e përgjegjësive" është rasti kur nuk plotësohet të paktën njëra prej kërkesave të pikës 2 të këtij neni për shkak dhe vetëm të ndikimit të mundshëm të interesave privatë të zyrtarit të UK-së, sipas pikës 1 të këtij neni.

4. "Zyrtar" është çdo person, që kryen detyra dhe ushtron funksione publike në UK.

5. "Person i lidhur me një zyrtar të UK-së" është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jopasurore me zyrtarin, sipas pikës 11 të nenit 3, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, në lidhje me nenin 5, të po këtij ligji.

6. "Parim i proporcionalitetit", sipas pikës 12 të nenit 3, të Ligjit 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, është raporti ndërmjet rëndësisë së detyrave, përgjegjësive dhe kompetencave të një zyrtari me masat për parandalimin e konfliktit të interesave, raport në të cilin sa më të rëndësishme të jenë detyrat, përgjegjësitë dhe/ose kompetencat e tij, aq më të shumta janë kufizimet e interesave vetjakë.

Neni 5

Fusha e zbatimit

Rregullorja përcakton norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zyrtar sipas kuptimit të këtij termi në pikën 4 dhe 5 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, kur ai merr pjesë në një vendimarrje për akte e kontrata administrative, si dhe akte normative.

1. "Conflict of interest" is the state of conflict between public duty and the private interests of a UK official in which he has direct or indirect private interests affecting can affect or seem to affect in performing so unfair of his public duties and responsibilities.

2. "Fair performance of duties and responsibilities" is the way of performing duties and responsibilities materialized in a decision-making in which the UK official acts in accordance with the law honestly indifference responsibility

commitment, in time, in defense, in any case of public interest and the legal rights of private persons as well as for maintaining and strengthening credibility of the dignity of the institution where he Works of the State in general and the figure of the official.

3. "Unfair performance of duties and responsibilities" is the case when not met at least one of the requirements of point 2 of this article due and only of potential impact of the private interests of the official of the UK, according to point 1 of this article. 4. "Official" is any person who performs duties and exercises public functions in the UK.

5. "Person connected with an UK's official" is any physical or legal person, who appears to have had or have interest, relations, property or personal non-property with the official, according to paragraph 11, of Article 3, of law no.9367, dated on 7.4.2005, as amended, in conjunction with Article 5, of the same law.

6. "Principle of proportionality", according to paragraph 12, of article 3, of law 9367, dated on 07.04.2005, amended, is the ratio between the importance of the duties, responsibilities and competences of an official with precautions measures to prevent conflicts of interest, a ratio in which the more important the duties, responsibilities and / or its competences, the more are the restrictions of personal interests.

Article 5

Rregullorja përcaktón norma të detyrueshme për t'u zbatuar nga:

1. Çdo zyrtar i UK-së që ndodhet në pozicione, ka përgjegjësi, kryen detyra ose ushtron kompetenca të llojeve konkrete, të përcaktuara shprehimisht në Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në Ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të dës nëpunësve publike", në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin dhe Rregulloret e UK-së;
2. Çdo zyrtar i UK-së, kur ai merr pjesë në një vendimarrje për akte dhe kontrata administrative;
3. Çdo zyrtar i UK-së, kur ai merr pjesë në një vendimarrje për kontrata që krijojnë marrëdhënie juridiko-civile;
4. Personat e lidhur në masën dhe mënyrën e përcaktuar në Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 dhe në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 6

Vendimarrja dhe çastet paraprake të vendimarrjes

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, në përputhje me Udhëzimin e ILDKPKI-së nr. 239, datë 2.2.2006, "Për kuptimin e çasteve paraprake dhe thelbësore në një vendimarrje", vendimarrje për një akt do të vlerësohen:

- a) në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit;
- b) edhe ato çaste paraprake të vendimarrjes, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit, që përfshijnë, por nuk janë të kufizuara si më poshtë:

1) hartimi i projektaktit nga zyrtari ose zyrtarët dhe dorëzimi i tij organit apo zyrtarit kompetent për vendimarrje;

Scope of implementation

Regulation assigns mandatory norms to be implemented by every official according to the meaning of that term in paragraph 4 and 5 of Article 4 of this regulation when he is part of a decision-making process on acts and administrative contracts, and normative acts.

The regulation sets the norm mandatory to be implemented by:

1. Every UK official located at positions has responsibilities performs duties or exercises competencies of concrete types expressly defined in Law no. 9367, dated 07.04.2005 "On the prevention of conflict of interest in the exercise of public functions" changed in Law no. 9049, dated 10.4.2003 "On the declaration and control of assets of the financial obligations of the elected and some public servants", in Law no. 80/2015 "On higher education and scientific research in higher education institutions in the Republic of Albania" in the Statute and Regulations of the UK;
2. Any UK official when he participates in a decision-making on administrative acts and contracts;
3. Any UK official when he participates in a decision-making for contracts that establish legal-civil relations;
4. Persons regarding the extent and manner specified by law no. 9367, dated on 07.04.2005, amended and on Article 30 of the Code of Administrative Procedures

Article 6

Decision-making and preliminary moments of decision-making

For the purposes of this regulation, in accordance with Instruction No. 239 of HIDAACI (High Inspectorate of Declaration and Audit of Assets and Conflict of Interest), dated on 2.2.2006, "On the understanding of the preliminary and essential moments in decision-making", decision-making on an act will be considered:

- a) in any case, the last moment of the decision-making process during which the final content of the act is decided;
- b) on an act would be considered even

2) dhënia e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, për këtë projektakt nga zyrtarë të tjerë, brenda ose jashtë institucionit;

3) dhënia e komenteve, mendimeve, sugjerimeve dhe çdo kontributi tjetër të dokumentuar, nga çdo zyrtar si pasojë e kërkesave, pretendimeve apo informacioneve të subjekteve të interesuara për këtë projektakt;

4) dhënia e komenteve, mendimeve, sugjerimeve e çdo kontributi tjetër të dokumentuar, të çdo zyrtari me kompetencë për të vendosur përfundimisht për aktin;

5) përfshirja e çdo dokumenti paraprak, ndërmjetës dhe/ose shoqërues të një vendimmarrjeje për një akt ose kontratë që lidhet kryesisht me organizimin, të ardhurat, shpenzimet, strategjitë, burimet njerëzore, funksionet, detyrat e përgjegjësitë administrative, pa praninë e të cilave nuk do të vendosej dhe mbështetëj përmbajtja përfundimtare e projektaktit ose projektkontratës në tërësinë e tyre;

6) çdo rast tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të misionit e të veprimtarisë së UK-së.

Neni 7

Kompetenca thelbësore dhe përcaktuese për një akt

1. Një zyrtar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas nenit 6 të rregullores, përcaktojnë përmbajtjen e aktit.

2. Si kompetencë thelbësore e përcaktuese e një zyrtari për një akt përfshihet, në secilin nga çastet paraprake të mësipërme të vendimmarrjes, mundësia për të ndikuar mbi vendimmarrjen që buron nga:

a) roli zyrtar urdhërues, propozues, këshillues, zbatues ose kontrollues i ushtruar, që rrjedh nga

those preliminary moments of decision, according to the letter "a" of this proposal, which are fundamentally important and determinant for the final content of the act, which include, but are not limited to the following:

1) compiling of the draft from the official or officials and submitting it to the body official or the responsible for decision-making;

2) provision of comments, opinions, suggestions and any other documentary contribution, for this draft by other officials, within or outside the institution;

3) provision of comments, opinions, suggestions and any other documentary contribution, by any official as a result of requests, claims or information to entities interested in this draft;

4) provision of comments, opinions, suggestions and any other documentary contribution of each official with the competence to finally decide on the act;

5) inclusion of any preliminary, provisional, and/or accompanying document of a decision-making for an act or contract connected with the organization, revenues, costs, strategies, human resources, functions, duties and administrative responsibilities, without the presence of which it will not be established the final content of the draft or draft contract in their entirety and supported;

6) any other case in accordance with the relevant specifications of mission of the UK's activity.

Article 7

Fundamental and definite competences to an act

1. An official has a fundamental and definitive competence to an act if his participation, influence and position in the decision-making for this act, under Article 6 of the regulation, determine the content of the act.

pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi në përgatitjen, negocimin, propozimin, këshillimin, miratimin, administrimin, kontrollin ose ekzekutimin e një akti apo kontrate;

b) zotërimi i informacionit, që lidhet kryesisht, por jo vetëm, me të dhëna sensitive për biznesin, të dhëna për tatimet e doganat, kuadrin rregullator, informacione sensitive personale, informacione për organet e hetimit e të ndjekjes, informacione për politikat ekonomike vendore dhe administrimin financiar;

c) çdo shkak tjetër në përputhje me specifikat konkrete e përkatëse të funksionit e të veprimtarisë së zyrtarëve të UK-së;

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave të mësipërme të kësaj rregulloreje, përbën çast paraprak të vendimmarrjes apo kompetencë thelbësore e përcaktuese për një akt ose kontratë, çdo rast i vlerësuar si i tillë nga autoriteti përgjegjës i UK-së, si dhe nga zyrtarët eprorë në UK.

4. Në secilin prej çasteve të mësipërme, zyrtari pjesëmarrës në vendimmarrje, me kompetencë thelbësore dhe përcaktuese, është i detyruar të vetëdeklarojë paraprakisht, në zbatim të pikës 1, të nenit 7, të Ligjit nr.9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar, nëse ka një interes privat që mund të shkaktojë rënien në konflikt interesi të çfarëdo lloji. Vetëdeklarimi bëhet nëpërmjet plotësimit të dokumentit tip për deklarime të këtij lloji.

5. Në të njëjtat raste, eprori ose institucioni epror mund t'i kërkojë zyrtarit të deklarojë rast pas rasti interesat private në zbatim të nenit 7, pika 2, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 8

Interesat private

1. Interesat private të një zyrtari janë interesat që parashikohen nga neni 5, i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar dhe konkretisht:

- a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloji natyre;
- b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;
- c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;
- ç) negocime të mundshme për punësim në të

2. As an fundamental and definitive competence of an official for an act is included, in each of the above preliminary moments of the decision-making, the possibility to have impact on the decision which stems from:

a) the imperative official proposing, advising, implementing role, or exercised controller with derives from participation, influence and position in the preparation, negotiation, proposal, advice, approval, management, control or execution of an act or contract;

b) the acquisition of information, related namely, but not only, to sensitive data about business data on tax and customs, regulatory framework, personal sensitive information, information about the investigative bodies of prosecution, information about local economic policies and financial management;

c) any other reason in accordance with the relevant and concrete specifications of the function of the officials' activity UK.

3. Despite of the provisions of the above paragraphs of this regulation, it considered as a preliminary moment of decision-making or fundamental and definitive competence to an act or contract, each case valued as such by the competent authority of the UK, and the superior officials in the UK.

4. In each of the above moments, the official participant in decision-making, with fundamental and despite competence, is required to self-declare in advance, pursuant to paragraph 1 of Article 7 of Law 9367, dated on 07.04.2005, as amended, if he has a personal interest that could cause a conflict of interest of any kind. Self-declaration is made by filling in the document type for declarations of this kind.

5. In same cases, the superior or the superior institution may ask the official to declare private interests case by case pursuant to Article 7, paragraph 2 of Law no. 9367,

ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdo lloj forme tjetër marrëdhënesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;

d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtari që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;

dh) marrëdhënie:

- 1) familjare apo të bashkëjetesës;
- 2) të komunitetit;
- 3) etnike;
- 4) fetare;
- 5) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;
- 6) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.

2. Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në Ligjin nr. 9367 datë 07.4.2005, i ndryshuar, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuar shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.

3. Nëse në Ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005, i ndryshuar, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasiar i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasiar, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për kriteret e përcaktuara në Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar dhe anasjellas.

4. Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdo lloj interesi privat i zyrtarit nga ata të përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4, të nenit 3, të Ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005, i ndryshuar.

dated on 07.04.2005,as amended.

Article 8

1. The private interests of an official are the interests foreseen by Article 5 of Law no. 9367, dated on 07.04.2005, as amended, and specifically:

- a) the rights and concretely liabilities of any kind;
- b) any other civil-legal relations;
- c) gifts, promises, favors, preferential treatment;
- ç) negotiations for potential future employment by the official during the exercise of his functions or negotiations on any other form of relationship with personal interest to the official after leaving the duty performed by him while on duty;
- d) commitments in private activities for profit or any kind of activity that generates income, as well as commitments in profit and nonprofit organizations, trade unions or professional organizations, political, governmental and any other organization;
- dh) relationships:
 - 1) family or cohabiting

2) community;

3) ethnic;


4) religious;

5) well-known friendship or enmity;

6) previous commitments of which have derived or are deriving interests mentioned in the above letters of this article.

2. Restrictions of private interests explicitly defined in law no. 9367, dated on 07.04.2005, as amended, are applied together with limitations of the same private interest, expressly defined in another law, according to the principle, that the restriction which is the most stringent is applied.

3. If in the law no. 9367, dated on 07.04.2005, as amended, in connection with a specific private interest of an official is specified no quantitative limit of this interest, while in another law, in order to prevent conflicts of interest, the same interest is expressly limited by a quantitative limit, then this limitation is applied even to the



KREU II

PROCEDURAT DHE MJETET PËR IDENTIFIKIMIN, REGJISTRIMIN DHE TRAJTIMIN E KONFLIKTEVE TË INTERESAVE

Seksioni 1

Identifikimi dhe regjistrimi i interesave në kushtet e konflikteve të interesave rast për rast

Neni 9

Deklarimi rast për rast i interesave privatë të zyrtarit

1. Çdo zyrtar i UK-së, sipas përcaktimit të këtij termi në nenin 5 të kësaj rregulloreje, në ushtrimin e kompetencave ose në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi.
2. Deklarimi rast për rast i interesave privatë bëhet çdo herë nga zyrtarët, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni epror. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi kërkohet dhe bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për një akt.

Neni 10

Identifikimi i interesave privatë të zyrtarit nga persona të tretë

1. Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit, është:
 - a) detyrë e çdo zyrtari që ka dijeni;
 - b) e drejtë e palëve të interesuara dhe e çdo personi, që ka dijeni dhe që ka një interes në

criteria specified in law no. 9367, dated on 07.04.2005, as amended, and vice-versa.

4. It is estimated as a reason for the emergence of conflicts of interest, any kind of personal interest of the official from those defined in Article 5 of Law no. 9367, dated on 07.04.2005, as amended, any connection or interlacement between two or more of them, whether because of this interest or due to leave the binding constraints of this interest, arises a situation with a conflict of interest, according to definitions of paragraphs 1 and 4, Article 3 of law no. 9367, dated on 07.04.2005, amended.

CHAPTER II

PROCEDURES AND TOOLS FOR IDENTIFICATION, REGISTRATION AND TREATMENT OF CONFLICTS OF INTEREST

Section 1

Identification and registration of interests in terms of conflict of interests case by case

Article 9

Case by case declaration of private interests of the official

1. Any official, as defined in this term in Art. 5 of this regulation, in exercise of his competences or in the performance of his public duties, on the basis of his knowledge and in good faith, is forced to make a previous self-declaration, case by case, of the existence of his private interest that could give rise to a conflict of interest.
2. Case by case declaration of private interests is made every time by the officials, when this is requested by the superior or the superior institution. The declaration, as a rule, must be required and made in advance. When this is not possible or when it has not happened, the declaration is required and made as quickly as possible.



përgjithësi, në përputhje me qëllimin e Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

2. Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari mund të jenë edhe ato burime të parashikuara në nenin 9, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

Neni 11

Lëshimi i autorizimit nga zyrtari

1. UK-ja vë në dispozicion të zyrtarëve të tij modelin e autorizimit që këta duhet të lëshojnë, brenda 30 ditëve nga data e fillimit të marrëdhënieve të punës.
2. Autorizimi dorëzohet në autoritetin përgjegjës të UK-së.

Neni 12

Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave

1. Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
2. Autoriteti/strukturat përgjegjëse për zbatimin e Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, dhe kësaj rregulloreje, sipas hierarkisë janë:
 - a) Titullari;
 - b) Zv/Titullari
 - c) Dekanët;
 - d) Përgjegjësit e departamenteve;
 - e) Administratori;
 - f) Kryetarët e organeve drejtuese dhe ekzekutive, si dhe të këshillave të UK-së;

3. Self-declaration or requested declaration is made in a written form, when the official is involved in a decision-making to an act.

Article 10

Identification of the private interests of the official by third party

1. Provision of the information about the private interests of the official is:
 - a) the duty of every official who is well-informed;
 - b) the right of interested parties and any other person who is well-formed and who has a general interest in accordance with the purpose of the law no. 9367, dated on 07.04.2005, as amended.
2. Other sources of information about the private interests of an official may even be those sources foreseen in Article 9 of Law no.9367, dated on 07.04.2005, as amended.

Article 11

Issue of official authorization

1. Is available to UK officials the authorization model which they must issue within 30 days from the date of beginning of the employment relationship.
2. The authorization is submitted to the UK authority responsible for it.

Article 12

The responsible authorities for the prevention, control and resolution of a conflict of interest

1. The central authority responsible for the implementation of this law is the High Inspectorate of Declaration and Audit of Assets



- g) Qendra e Formimit të Vzhduar;
- h) Përgjegjësi i EDE-së (njësi e UK-së)
- i) Drejtorët e drejtorive të administratës së Rektoratit të UK-së;
- j) Përgjegjësit e Sektorëve të administratës së Rektoratit të UK-së.

3. Autoriteti përgjegjës në UK, i cili zbaton detyrat e përcaktuara në Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar dhe në nenin 13, të kësaj rregulloreje është drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivit, në cilësinë e drejtuesit të autoritetit përgjegjës, si dhe përgjegjësi i Sektorit Juridik dhe Protokoll-Arkivit dhe specialisti i protokollit, në cilësinë e anëtarëve të këtij autoriteti.

Neni 13

Detyrat e Autoritetit Përgjegjës të UK-së

Autoriteti përgjegjës i UK-së, kryen detyrat sipas Udhëzimit nr. 1, datë 27.06.2014, të ILDKPKI-së. Këto detyra janë si më poshtë:

1. Mbledh nga burime të ligjshme të dhëna për interesat private të zyrtarëve

a) Shpërndan dhe administron autorizimet e lëshuara nga zyrtarët në zbatim të nenit 10 të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar. Autorizimi, sipas formatit të miratuar nga Inspektori i Përgjithshëm, është i detyrueshëm për t'u plotësuar nga çdo zyrtar, i cili kryen një funksion publik dhe nënshkruhet brenda 30 ditëve nga data e fillimit të detyrës.

b) Në emër të institucionit publik, mbledh të dhëna personale për zyrtarin, kudo që ato janë të regjistruara në regjistrat publikë, të cilat lidhen me interesat private, që mund të krijojnë ose duket sikur krijojnë konflikt interesi me funksionin publik apo detyrat që ushtron zyrtari. Mbledhja e këtyre të dhënave duhet të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

2. Propozon nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore, si dhe ndryshimet në rregulloret e

and Conflict of Interest.

2. The responsible authority or structures for the implementation of Law no. 9367, dated on 07.04.2005, as amended, and of this regulations, according to the hierarchy are:

- a) Head of the institution;
- b) Deputy/Head
- c) Deans;
- d) Heads of departments;
- e) Chancellor;
- f) Heads of governing and executive bodies, and the UK's councils;
- g) Heads of centers of excellence;
- h) Head of the UK's unit EDE;
- i) Heads of the Branches of the administration of the UK's Rectorate;
- j) Heads of the Sectors of the administration of the UK's Rectorate;

3. The responsible authority in the UK, who performs the tasks assigned in Law no. 9367, dated on 07.04.2005, as amended, and in article 13 of this regulation is the Head of the Human Resources and Protocol-Archive Branch, as the head of the responsible authority of the institution, and the lawyer of the institution and protocol-archive specialist, as members of this authority.

Article 13

Duties of the UK Responsible Authority

The Responsible Authority of the UK performs his duties according to the Instruction no. 1, dated 27.06.2014, of HIDAACI. These duties include:

1. It gathers data (information) from legal sources about private interests of it'sofficials

brendshme për parandalimin e konfliktit të interesave të institucionit, në përputhje me ligjin e parandalimit të konfliktit të interesave, si dhe udhëzimeve të ILDKPKI-së.

3. Detyrat e autoriteteve përgjegjëse për konstatimin, trajtimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave.

Autoriteti përgjegjës, në emër të institucionit, kryen verifikim dhe hetim administrativ lidhur me interesat private, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi, në të gjithë regjistrat publikë apo institucione të tjera duke shfrytëzuar të gjithë mundësitë që i jep ligji dhe informon për këtë eprorin e drejtpërdrejtë deri tek titullari i institucionit:

- a) Autoriteti përgjegjës pranon informacion të ofruar nga zyrtarë të tjerë apo persona të interesuar, të siguruar në mënyrë të ligjshme dhe verifikon/kontrollon burimin dhe vërtetësinë e këtyre të dhënave.
- b) Në bazë të informacionit të grumbulluar, autoriteti përgjegjës, bazuar në Ligjin nr. 9367, datë 7.4. 2005, i ndryshuar, vlerëson, nëse rasti konkret përbën konflikt interesi, duke analizuar njëkohësisht si rolin, ashtu edhe kompetencat e zyrtarit në procesin vendimmarrës.
- c) Verifikon dhe vlerëson, nëse nga situata e konstatuar në kushte të konfliktit të interesit, kanë ardhur pasoja.
- d) I komunikon vetë zyrtarit dhe eprorit të dhënat e mbledhura dhe shkeljet e konstatuara, duke i orientuar gjithashtu për masat që duhet të marrë vetë zyrtari apo eprori për zgjidhjen e konfliktit, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 37 dhe 38, të ligjit nr.9367, date 7.4.2005, i ndryshuar.
- e) Plotëson dhe administron regjistrin e konfliktit të interesit rast për rast, i cili duhet të përmbajë të dhëna lidhur me:
 - 1) Identitetin e zyrtarit;
 - 2) Interesat privatë të tij, të cilët janë bërë shkak për një konflikt interesi;
 - 3) Thelbin e konfliktit;
 - 4) Palët e interesuara;
 - 5) Burimin e të dhënave, mënyrën e marrjes dhe të verifikimit të tyre;
 - 6) Vendimin që është marrë, mbështetur në këto të

a) It distributes and manages authorizations issued by officials in accordance with article 10 of Law 9367 dated 7.4.2005, as amended. The authorization according to the format approved by the General Inspector, and must be completed by each official, who performs a public function and must be signed within 30 days from the beginning of the duty exercises.

b) On behalf of the public institution, it collects personal information about the official, recorded in public registers, which are linked to private interests and could create a conflict of interest with his public function or his exercised duties. The collection of these data must be done in accordance with law No. 9887, dated 10.03.2008, "On protection of personal data", as amended.

2. It proposes necessary normative acts, and changes in the inner regulations to prevent conflicts of interest of the institution, in accordance with the law and HIDAACI instructions.

3. Duties of Responsible Authorities for identifying, treating and resolving conflicts of interest. The Responsible Authority, on behalf of the institution, verifies and performs administrative investigation regarding private interests, which can cause conflicts of interest in all public registers or other institutions by exploiting the opportunities given by the law, and informs his superior or the head of the institution:

a) The Responsible Authority receives information provided by other officials or interested persons, legally insured and verifies/checks the source and authenticity of the data.

b) Based on the collected information, the Responsible Authority, in accordance with the Law no.9367, dated 7.4.2005, as amended, assess whether the specific case represent a conflict of interest, and at the same time analyzes the role and competences of the official in the decision-making process.

c) Verifies and assesses whether the identified situation in terms of conflict of interest has it consequences.

d) He communicates to the official and the superior, the data collected and the observed violations, by providing orientation on the measures to be taken by the official or superior in order to resolve the conflict, as stipulated in Articles 37 and 38 of Law No.9367, dated 7.4.2005, as amended.

dhëna, përfshirë edhe vendimet e marra nga eprorët, institucionet eprorë ose nga gjykatat.

f) Mbështet eprorin, sipas rastit, për marrjen e masave disiplinore dhe raporton rastin në ILDKPKI për ndjekje të mëtejshme.

4. Rregullimi i pasojave juridike, pavlefshmëria e akteve/kontratave administrative të marra në kushtet e konfliktit të interesave

4.1 Autoriteti përgjegjës në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse, e cila trajton çështjet juridike:

a) Merr masa për të lehtësuar ankimin administrativ të palëve të interesuara në lidhje me aktet e marra në kushtet e konfliktit të interesit.

b) Siguron transparencën me publikun lidhur me vendimmarrjet e kryera nga institucioni përkatës dhe zbatimin me korrektësi të Ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit".

4.2 Shtron çështje dhe kërkon këshilla nga ILDKPKI për zbatimin e Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, si dhe bën përmirësime në ligje të tjera, kur kjo ka të bëjë me çështjen e konfliktit të interesave;

4.3 I propozon me shkrim organit kompetent (eprorit /institucionit epror) revokimin/shfuqizimin e akteve të marra në kushtet e konfliktit të interesave.

4.4 Në rastet e konstatimit të pavlefshmërisë së një akti/kontrate administrative të institucionit publik, sipas përkufizimit të këtij termi në Kodin e Procedurave Administrative, si pasojë e nxjerrjes së tyre në kushtet e konfliktit të interesave (faktik apo në dukje), autoriteti përgjegjës, në bashkëpunim me strukturën përkatëse, në zbatim të nenit 40/1, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, kur gjykon se zyrtari ka vepruar me keqbesim:

a) I propozon eprorit/organit kompetent fillimin e procedurave të dënimit disiplinor ndaj zyrtarit përgjegjës për pavlefshmërinë e aktit;

b) Propozon të ndërmerren procedurat për kalimin e barrës së dëmshpërblimit të ky zyrtar;

c) Inicion fillimin e procedurave të ankimit pranë organit gjyqësor për vendosjen e një shpërblimi në favor të institucionit për dëmin moral të shkaktuar;

d) Propozon të bëhet kallëzim penal ndaj zyrtarit,

e) He fills and manages the register of the conflict case by case, which must include data related to:

1) The **identity** of the official;

2) His **private** interests, which have caused the conflict of interest;

3) The essence of the conflict;

4) Stakeholders;

5) Data source, the way of obtaining and verifying them;

6) The decision taken based on these data, including also decisions made by superiors, superior institutions or the courts;

f) Supports the superior, as appropriate, to undertake disciplinary measures and reports on HIDAACI for further pursuit of the case.

4. Regulation of the legal consequences, the invalidity of contracts administrative acts/obtained in terms of conflict of interest

4.1 The Responsible Authority in cooperation with the responsible body, which deals with legal issues:

a) Takes precautions to simplify the administrative complaint of the interested parties, with respect to acts taken in terms of a conflict of interest.

b) Provides transparency to the public about decisions made by the relevant institution and the correct implementation of the Law No.8503, dated 30.06.1999, "On the right of access to official documents".

4.2 Raises issues and asks HIDAACI for advice on implementation of law no.9367, dated 07.04.2005, as amended, and improvements in other laws, when it has to do with the issue of conflict of interest;

4.3 Proposes in a written form to the competent organ (supervisor/superior institution) revocation /abrogation of actions undertaken in term of a conflict of interest.

4.4 In the case of invalidity of an administrative act/contract of the public institution, according to the definition of this term in the Administrative Procedure Code, as a result of issuing them in terms of a **conflict of interest** (actual or apparent), the Responsible Authority, in cooperation with the relevant structure, pursuant to Article 40/1 of the law 9367, dated 07.04.2005, as amended, when judging that the officer acts incorrectly:

a) Proposes to the superior / competent organ to initiate disciplinary procedures against the official, responsible for the invalidity of the act;

b) Proposes to the superior to undertake the

nëse gjykohet se shkelja e kryer nga ai përbën veprë penale;

Këto masa të sipërcituara, mund të zbatohen edhe ndaj çdo zyrtari tjetër përgjegjës, që me veprimet apo mosveprimet e veta nuk ka parandaluar konfliktin e interesit, shkak për pavlefshmërinë e aktit, ose për moszbatimin e detyrimeve për shmangien e konfliktit të interesave të përcaktuara në ligj.

5. Roli këshillues dhe trajnues i autoriteteve përgjegjëse

a) Autoriteti përgjegjës i sugjeron zyrtarëve dhe/ose eprorëve të tyre çështjet dhe momentet kur zyrtarët dhe/ose eprorët e tyre duhet të tregohen të kujdesshëm për parandalimin e konfliktit të interesit rast për rast ose të vazhdueshëm (faktik, në dukje dhe i mundshëm).

b) Mbështet eprorin e zyrtarit në vlerësimin e kryerjes së padrejtë të detyrave për shkak të konfliktit të interesit, në marrjen e masave disiplinore apo në propozimin për vendosjen e gjobave nga ILDKPKI, në rast kundërvajtjesh administrative të zyrtarit, në kuptim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

c) Përgatit guida, informon, këshillon e trajnon zyrtarët në lidhje me këtë ligj, me të drejtat e detyrimet e tyre dhe me parandalimin sa më të mirë të konfliktit të interesave;

d) Merr masa për të siguruar aksesin dhe informimin e publikut në të dhënat personale të zyrtarëve dhe në dokumentet e tjera zyrtare që lidhen me konfliktin e interesit.

6. Detyrat e autoriteteve përgjegjëse në procesin e deklarimit

a) Autoriteti përgjegjës në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 3 të Ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, duhet të përgatisë listën e përditësuar të zyrtarëve, të cilët, në varësi të funksionit që kryejnë, mbartin detyrimin për deklarim të interesave private dhe të dërgojë kopje të saj në ILDKPKI;

b) Në rastet e emërimeve dhe largimeve të zyrtarëve që mbartin detyrim për deklarim, duhet të njoftojë menjëherë me shkrim ILDKPKI, lidhur me datën e emërimit/largimit të subjekteve.

necessary procedures for transfer of compensation to the official;

c) Begins the appeal procedures near the judicial body, for setting compensation in favour of the institution for the moral damage;

d) Proposes to press charge against the official, if judged that the offense committed by him is a penal offense;

The measures mentioned above, can be applied to any other responsible official whose acts or passivity does not prevent conflicts of interest, or a cause for the invalidity of the act, or failure of duties and obligations to avoid conflicts of interest defined in law.

5. The advisory and training role of the Responsible Authorities

a) Responsible Authority suggests to officials and / or their superiors, issues and moments when officials and / or their superiors should pay attention to the prevention of conflicts of interest in a specific case or in continuation. (actual, apparent and potential).

b) Supports the superior of the official in assessing the improper performance of the duties because of the conflict of interest, in taking disciplinary measures or in the proposal for the imposition of fines by HIDAACI in case of administrative offenses of the official according to the law nr. 9367 dated 07.04.2005, as amended.

c) Prepares guides, informs, advises and trains officials in accordance with this law, with their rights and obligations and the best way to prevent conflicts of interest;

d) Takes measures to provide access and information to public, on personal data of the officials and other official documents related to the conflict of interest.

6. Duties of the Responsible Authorities in the declaration process

a-Responsible Authority pursuant to the provisions made in article 3 of the Law no.9049, dated 10.4.2003, "On the declaration and audit of assets, financial obligations of elected officials and certain public officials", as amended, must prepare the officials updated list, who, depending on their function, have the obligation to declare their private interests and to send copies of the list to the HIDAACI;

b) In cases of hiring and dismissals of officials who are obliged to declare, the responsible authority should immediately notify the written form HIDAACI, about the date of employment



c) Orienton dhe udhëzon zyrtarët, të cilët mbartin detyrim për deklaram, për plotësimin në rrugë elektronike (me kompjuter) të deklaratës së interesave private, sipas llojeve (para fillimit të detyrës, periodik vjetor, pas largimit nga funksioni);

d) Informon zyrtarët lidhur me afatet ligjore, brenda të cilave plotësohet dhe dorëzohet deklaratat e interesave private;

e) Informon zyrtarët lidhur me sanksionet në rast refuzimi për plotësim të deklaratës, në rast mosplotësimi brenda afatit, si dhe në rastin e deklarameve të rreme;

f) Jep asistencë, nëse kërkohet nga ana e zyrtarëve, në plotësimin e deklaramave;

g) Mban databazë për shpërndarjen dhe dorëzimin e deklaramave të interesave private të zyrtarëve dhe pasi verifikon se dokumenti zyrtar është pa mangësi, lëshon për subjektin vërtetimin e marrjes në dorëzim.

h) Mbledh deklaramat e plotësuara nga zyrtarët (subjekte të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar) dhe i dërgon pranë ILDKPKI, sipas listës emërore të dorëzimeve.

i) Përgatit, jo më vonë se data 31 janar e vitit pasardhës, raportin vjetor mbi veprimtarinë e kryer dhe e dërgon në ILDKPKI.

7. Raportimi vjetor mbi veprimtarinë e autoriteteve përgjegjëse

Në zbatim të pikës 3, të nenit 42, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, autoritetet përgjegjëse i paraqesin Inspektoratit të Lartë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklaramin periodik.

Raporti vjetor duhet të përmbajë:

a) Për procesin e deklaramit të interesave private periodike:

1) Njoftimin, dhënien e konsulencës dhe dorëzimit të deklaramave të interesave private nga zyrtarët, si dhe respektimin e afateve ligjore nga ana e tyre.

2) Rakordimin e listës së zyrtarëve që mbartin

/ dismissal of the subjects.

c) Directs and instructs officials to fill in an electronic form a statement of private interests, by type (Before beginning the job, annual, and after leaving the office);

d) Informs the officials about the legal deadlines within which they must complete and submit the declaration of private interests;

e) Informs officials about sanctions in case of refusal to fill in the declaration, in case of default by the deadline, and in case of false declarations;

f) Provides assistance, if required by the officials in filling in such declarations

g) Keeps a database for the distribution and submission of the officials' declarations of private interests and after verifying that the official document is complete, issues a certificate.

Collects the completed declarations by the officials (subjects of the law no.9049, dated 10.4.2003, "On the declaration and audit of assets, financial obligations of elected officials and certain Public officials ", as amended, and sends them to the HIDAACI, according to the list of submissions.

i) Prepares no later than January 31, of the following year, an annual report on the performed activities and sends it to ILDKPKI.

7. Annual report on the activities of the Responsible Authorities

Pursuant to paragraph 3 of article 42 of Law 9367, dated 7.4.2005, the Responsible Authorities shall submit an annual report to the High Inspectorate, no later than January 31, on the activities carried out in the previous year, pursuant to this law, including cases of conflicts of interest, the ways used for their prevention or treatment, the achieved results, and issues related to periodic declaration.

The annual report must include:

a) For the process of the periodic declaration of private interests:

1) Notification, consulting service and submission of officials' declarations of private interests, within legal deadlines on their part.

2) The reconciliation of the list of the officials who have the obligation to declare their private interests.

3) Identification of cases of non-compliance with the legal deadlines for submitting the declarations of private interests.

4) Identification of disciplinary measures undertaken for violations of the law no.9049

detyrim për deklarimin e interesave private.

3) Evidentimin e rasteve të mosrespektimit të afateve ligjore për dorëzimin e deklaratave të interesave private.

4) Evidentimin e marrjes së masave disiplinore për shkelje të konstatuara të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

b) Për identifikimin dhe regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave:

1) Plotësimin e autorizimit për parandalimin e konfliktit të interesave nga çdo zyrtar;

2) Identifikimin, regjistrimin e rasteve të konfliktit të interesave;

3) Raste të verifikuara dhe të kontrolluara për konflikt interesi;

4) Raste të trajtuara dhe të zgjidhura të konfliktit të interesave;

5) Raste të pazgjidhura të raportuara në ILDKPKI, gjykatë, prokurori.

8. Përgjegjësitë e autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave

a) Autoriteti përgjegjës duhet të respektojë gjatë gjithë kohës së ushtrimit të veprimtarisë së tij (edhe pas largimit të zyrtarit nga funksioni), parimet e konfidencialitetit dhe besueshmërisë në përputhje me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

b) Në rastet kur konstatohen shkelje të detyrimeve ligjore nga kjo strukturë, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së i propozon titullarit të institucionit masë disiplinore, në zbatim të pikës 3, të nenit 45, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, si dhe ndërmer procedurat për vendosjen e masave administrative "gjobë", në zbatim të nenit 44, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar.

9. Kryerja e detyrave dhe ushtrimi i kompetencave nga ana e autoriteteve përgjegjëse në funksion të parandalimit të konfliktit të interesave, duhet të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 14

dated 10.4.2003, as amended and the Law 9367, dated 7.4.2005, as amended.

b) The identification and registration of cases of conflict of interest:

1) The authorization for the prevention of the conflict of interest by any official;

2) Identification and registration of cases concerning the conflict of interests.

3) Verification of issues related to the conflict of interest.

4) Treated and resolved cases of conflicts of interest.

5) Unsolved cases that are reported to HIDAACI, court, prosecution.

8. Responsibilities of Authorities

Responsible for the prevention of conflict of interest

a) The Responsible Authority must respect all the time (even after quitting the job), the principles of confidentiality and reliability in accordance with the provisions in Law no. 9887, dated 10.03.2008 "On the protection of personal data".

b) In cases when violations of legal obligations by this structure are noticed, the General Inspector of ILDKPKI, proposes disciplinary measures to the head of the institution, pursuant to paragraph 3 of article 45 of Law 9367, and undertakes procedures for taking administrative measures "fine", pursuant to article 44 of law 9367, dated 7.4.2005, as amended.

